


RIFINITURA



BETOFINISH

Ngjyra	Paketimi	Konsumi
Gri	Thes, 20 Kg	1.2-1.5 (kg/m ²)/mm trashësi

PËRSHKRIM

Stuko patinimi kundra lagështirës me bazë çimento gri, rërë mermeri të cilësisë së lartë, rezina sintetike speciale dhe aditivë specifike. I perforcuar me fibra. Karakterizohet nga një punueshmëri e shkëlqyer, hapje shumë e mirë si në sipërfaqe horizontale ashtu dhe vertikale. Lejohet aplikimi 3 deri në 5 mm trashësi për shtresë.

FUSHA E APLIKIMIT

Përdoret për stukimin e mureve dhe tavaneve në sipërfaqet e betonit, për ambiente të jashtme dhe të brëndshme. Stukoja e patinimit duhet të aplikohet në temperaturë nga +5°C deri në +35°C. Ideal për mbushjen dhe riparimin e sipërfaqeve të betonit me plasaritje të vogla. Për riparimin dhe ristrukturimin e sipërfaqeve të dëmtuara gjatë betonimit. Mbi sipërfaqe betoni me porozitet të lartë.

PËRGATITJA E BAZAMENTIT

Bazamenti duhet të jetë i pastër pa pluhura, vajra, bojra apo mbetje të cilat bëhen pengesë në lidhjen midis shtresave. Pastrimi i bazamentit bëhet në mënyrë mekanike ose manuale. Nëse suporti ka disnivele të mëdha atëherë duhet të bëhet nivelimi i tij dhe aplikimi i një primer-i të përshatshëm deKOLL.

PËRGATITJA E PRODUKTIT

Përziejme 6–6.5 l ujë të pastër me 20 kg produkt, masa e krijuar rekomandohet të përziehet me një përzierës elektrik derisa të formohet një masë homogjene. Masa e krijuar lihet në qetësi për 5 minuta dhe rekomandohet të përziehet përsëri përpara përdorimit. Aplikoni produktin me një mallë inoksi dhe bëni nivelimin e tij. Produkti aplikohet me dy shtresa ku trashësia maksimale për shtresë arrin 3-5 mm. Kushtet atmosferike ndikojnë në kohën e tharjes së produktit.

TË DHËNAT TEKNIKE

Pamja: Pluhur	Ujë për përzierjen: 6 - 6.5 litra/thes
Paketimi: Thes letre 20 kg në paleta 1080 kg	Trashësia maksimale e aplikimit për thes: 5mm
Ngjyra: Gri	Shtresat e aplikimit: Dy duar
Kokrrizimi: < 0.3 mm	Temperatura e aplikimit: +5°C deri në +35°C
Konsumi: 1.2 kg/m ² /mm	Koha e pritjes për aplikimin e bojës: Minimalisht 3 ditë
Magazinimi: Të ruhet në vënde të thata mbi paleta druri	Rezistenca në shtypje: ≥ 15 N/mm ²
Koha e magazinimit: 12 muaj nga data e prodhimit	Aftësia ngjitëse në beton (28 ditë): ≥ 1 N/mm ²
Masa vëllimore në të thatë: 1300 kg/m ³	Reaksioni ndaj zjarrit: A1 Class
Masa vëllimore e llaçit të njomë: 1700 kg/m ³	

